

VENDIM
Nr. 654, datë 31.10.2018

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
SË HUAS DHE TË PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT
TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “LINJA UNAZORE 110
KILOVOLT E SHQIPËRISË SË JUGUT”, NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 500 000
EUROSH, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 10251, DATË 11.3.2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të Marrëveshjes së Huas dhe të Projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 500 000 eurosh, të ratifikuar me ligjin nr. 10251, datë 11.3.2010, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3,
Tiranë, Shqipëri
Tel.: +355 4 2228405
Faks: +355 4 2228494

Në vëmendje të:

Operatorit të Sistemit të Transmetimit
Autostrada Tiranë–Durrës
Km 9, Kashar
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

**Bashkëpunimi Financiar i Qeverisë Gjermane
me Qeverinë Shqiptare**

Datë 4 korrik 2018

KfW Development Bank

Zgjatja e afatit të disbursimit

Linja Unazore 110 kV e Shqipërisë së Jugut

Sarah Bongard

Ref. jonë.: BghS

Tel: +49 69 7431-2185

Faks: +49 69 7431-2944

Sarah.Bongard@kfw.de

Marrëveshja e Huas dhe e Projektit

Datë 4 janar 2010

Shuma 500,000.00 euro

BMZ-nr. 2006 65 505

Nr. i llogarisë së huas: 8243598

E ndryshuar herë pas here (**Marrëveshja**)

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur dhe kërkesës suaj të datës 11 qershor 2018 për një zgjatje të afatit të disbursimit. Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se kemi rënë dakord për shtyrjen e afatit të disbursimit deri më 30 dhjetor 2018.

Në vijim, jemi dakord me ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes.

Seksioni A. Ndryshimi i Marrëveshjes

Marrëveshja (BMZ-nr. 2006 65 505) do të ndryshohet si më poshtë:

1. Termi “Ministria e Financave” do të fshihet dhe do të zëvendësohet nga “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, kudo që përmendet në tekstin e Marrëveshjes së Huas dhe të Projektit.

2. Neni 3.2 do të fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas 30 dhjetorit 2018. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të zgjasë afatin, duke njoftuar Huamarrësin sipas gjykimit të saj.”.

3. Në nenin 7.3 adresa për njoftimin e Huamarrësit do të fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“Për Huamarrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Tel.: +355 4 2228405

Faks: + 355 4 2228494”.

Seksioni B. Dispozita të tjera

1. Kjo letër nuk e ndryshon ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 6 (Kostot dhe tarifat publike), nenit 7.3 (Adresat, forma e shkruar dhe e amenduar), nenit 9.1 (Përputhshmëria), neni 9.3 (Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë), nenit 9.6 (Ligji i zbatueshëm) dhe nenit 9.7 (Mosmarrëveshjet ligjore - Arbitrazhi) të Marrëveshjes do të përfshihen në këtë letër, siç janë përcaktuar në mënyrë të plotë në të dhe siç referencat në këto dispozita të Marrëveshjes janë referenca në këtë letër.

3. Ju lutem konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin dhe dispozitat shtesë të përcaktuara më sipër, duke nënshkruar në një formë ligjërish të detyrueshme dhe duke na kthyer një kopje sa më shpejt të jetë e mundur.

Me respekt,

KfW

Rainer Sünner

Menaxhere Projekti

Sarah Bongard

Menaxher Kryesor

i Projektit

Lexuar dhe nënshkruar:
Tiranë, 5.10.2018

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Emri: Arben Ahmetaj
Titulli: Ministër

.....

Për dhe në emër të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)
Emri: Klodian Gradeci
Titulli: